



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.117

24 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.5780 datë 30.6.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	5137
Vendim i KM nr.990, datë 11.6.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	5137
Vendim i KM nr.991, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, në vështirësi”	5138
Vendim i KM nr.992, datë 2.7.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.70, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave “Për evidentimin e punëkërkuesve të papunë”, të ndryshuar	5138
Vendim i KM nr.993, datë 2.7.2008	Për një shtesë në vendimin nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”	5139
Vendim i KM nr.994, datë 2.7.2008	Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin	5139
Vendim i KM nr.995, datë 2.7.2008	Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi	5143
Vendim i KM nr.996, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”, të ndryshuar	5144

Vendim i KM nr.997, datë 2.7.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të ndryshuar ...	5146
Vendim i KM nr.998, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të shtëpisë së pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës”, të ndryshuar	5149
Vendim i KM nr.999, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, të ndryshuar	5152
Vendim i KM nr.1000, datë 2.7.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	5154
Vendim i KM nr.1001, datë 2.7.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura”, të ndryshuar ...	5171
Vendim i KM nr.1002, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, të ndryshuar	5173
Vendim i KM nr.1003, datë 2.7.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar	5175
Udhëzim i MF dhe METE nr.6364, datë 3.7.2008	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”..	5177

DEKRET
Nr.5780, datë 30.6.2008

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenev 15, 19 dhe 20 të ligjit n.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Petrit Nihat Serezi | 20. Anila Zef Xhani (Stajka) |
| 2. Liliana Besim Serezi (Vogla) | 21. Brendon Bashkim Xhani |
| 3. Holta Petrit Serezi | 22. Emanuela Ibrahim Bajrami |
| 4. Gerti Petrit Serezi | 23. Grigor Todi Nannushi |
| 5. Fatjon Stiljan Thomai | 24. Norka Kostaq Nanushi (Leka) |
| 6. Dëshir Fadil Çizmja | 25. Mariola Grigor Nanushi |
| 7. Artita Dëfrim Berisha (Kosova) | 26. Irena Grigor Nanushi |
| 8. Hatixhe Eqerem Alushi (Myrtollari) | 27. Josif Mitër Shqau |
| 9. Shaqe Nikë Gecaj | 28. Sane Kostandin Shqau (Toçi) |
| 10. Belma Skënder Daullxhiu (Halili) | 29. Elton Josif Shqau |
| 11. Gino Çafa Mühlbacher (Nuhu) | 30. Rozeta Jorgji Schön (Sema) |
| 12. Valbona Ali Cenolli (Emmini) | 31. Eric Stephan Wihelm Schön |
| 13. Klaudio Haxhi Toluli | 32. Liljana Jonuz Anger (Muzhaqi) |
| 14. Bledar Sazan Veliterna | 33. Lulzim Haxhi Koni |
| 15. Nikoll Zef Dodaj | 34. Vjollca Mehmet Koni (Ajasllari) |
| 16. Marcus Nikoll Dodaj | 35. Danjel Lulzim Koni |
| 17. Anita (Drita Mark Dodaj (Kaçorri) | 36. Xhemile Zylfo Horstmann (Lile) |
| 18. Etien Nikoll Dodaj | 37. Mario Ilir Pajo |
| 19. Eder Nikoll Dodaj | 38. Betullë Faik Hoxha |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.990, datë 11.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË
BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, fjalët "...sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1975 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,..." zëvendësohen me "...sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë",...".

b) Në pikën 4, fjalët "...sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1975 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,..." zëvendësohen me "...sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë",...".

2. Efektet financiare, prej 95 000 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë) lekësh, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 17.2.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.991, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.48, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I
NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË, NË VËSHTIRËSI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën "b" të pikës 1 të vendimit nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, fjalët "...duke filluar nga muaji i nëntë..." zëvendësohen me "...në muajin e pestë a të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.992, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.70, DATË 11.2.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR EVIDENTIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 5 të vendimit nr.70, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "...tre muaj..." zëvendësohen me "...një muaj...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.993, datë 2.7.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT
NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 8, 11 e 12 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të paragrafit të parë të pikës 7 të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Po nga këto fonde, zyra përkatëse e punësimit bën edhe derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.5 për qind të pagës minimale, i cili derdhet në degën përkatëse të sigurimit shoqëror të detyrueshëm.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.994, datë 2.7.2008

PËR TËRHEQJEN E MENDIMIT TË PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE PËR MJEDISIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 3 të konventës së Aarhusit, ratifikuar me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Konventë”, konventa “Për të drejtën e publikut për t’u informuar, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore” (konventa e Aarhusit), ratifikuar me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

b) “Autoritet publik”:

i) organet shtetërore qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore;

ii) personat fizikë ose juridikë, që kryejnë funksione publike, administrative, sipas ligjit, përfshirë dhe detyra, veprimtari ose shërbime të veçanta për mjedisin;

iii) çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike ose që ofron shërbime publike për mjedisin, nën kontrollin e një organi apo personi, të përmendur në nënndarjet (i)

e (ii).

c) “Publik i ndikuar”, publiku i ndikuar, që mund të ndikohet apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore, që shprehin interes.

2. Termat e tjera, të përdorura në këtë vendim, kanë kuptimin e termave të përdorur në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

KREU II

PJESËMARRJA E PUBLIKUT TË NDIKUAR NË HARTIMIN E POLITIKAVE, TË STRATEGJIVE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT, NË ZBATIM TË TYRE, QË KANË LIDHJE ME MJEDISIN

1. Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, të strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithshme a sektoriale, dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve, që përmirëson përmbytjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.

2. Autoritetet publike gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij kreu, pjesëmarrjen e publikut të ndikuar e realizojnë:

a) duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm për këto dokumente;

b) me përcaktimin e rregullave dhe të procedurave sa më të thjeshta;

c) me sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij.

3. Për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij, autoritetet publike, zbatojnë procedurat, si më poshtë vijon:

a) Në përputhje me natyrën dhe përmbytjen e dokumentit të hartuar, e identifikojnë atë, që përbën publikun e ndikuar për rastin konkret;

b) Organizojnë njoftimin e publikut të ndikuar, se është hartuar projekti i dokumentit, që do të bëhet objekt i debatit publik dhe e ftojnë publikun të njihet me të e të përgatitet për debat.

4. Njoftimi i publikut të ndikuar bëhet nga autoriteti publik, që ka ndërmarrë hartimin e dokumentit. Njoftimi shpallet vazhdimisht gjatë 30 ditëve:

a) në radio e TV, kombëtare e vendore;

b) në faqen e internetit të autoritetit;

c) në botime, të përditshme apo periodike, nëse është e mundur;

ç) në tabelën e njoftimeve, në vend të dukshëm.

5. Njoftimi shoqërohet me:

a) të dhënat, në mënyrë të përmbledhur, të dokumentit, objekt debati, që orienton publikun në çështjet më kryesore, për të cilat kërkohen vërejtjet, sugjerimet e propozimet e tij;

b) përmbledhjen, të përgatitur në gjuhën shqipe, me terminologji të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun;

c) njoftimin e vendit, ku qëndron i depozituar teksti i plotë i projektit të dokumentit, për t’u lexuar nga publiku i ndikuar;

ç) përcaktimin e afatit kohor për dhënien e mendimit, i cili është jo më pak se 1 muaj nga data e fundit e shpalljes së njoftimit;

d) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të diskutimit me publikun e ndikuar.

6. Përfaqësuesit e organit, që ka hartuar projektin e dokumentit, drejtojnë takimin, i krijojnë publikut lehtësi procedurale që përfaqësuesit e tij të shprehin lirisht, dhe mbajnë procesverbalin e takimit, ku regjistrohen të gjitha vërejtjet, sugjerimet e propozimet e publikut.

7. Grupi hartues i dokumentit e ripunon atë, duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, dhe harton relacionin, që shoqëron projektdokumentin, ku pasqyrohen vërejtjet e publikut, që nuk janë reflektuar në të, duke shpjeguar edhe arsyt pse nuk janë marrë parasysh.

8. Relacioni i përcillet organit vendimmarrës, së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

9. Dokumentet e përmendura në pikën 1 të kreut II të këtij vendimi, nuk mund të miratohen, nëse nuk plotësojnë kërkesat e këtij kreu, për tërheqjen e mendimit të publikut.

KREU III
PJESËMARRJA E PUBLIKUT GJATË PËRGATITJES SË PROJEKTAKTEVE NORMATIVE
PËR MJEDISIN

1. Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së projektakteve normative mjedisore, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) ndërmerr këto hapa:

a) Publikon matricën e akteve, që do të hartohen e miratohen gjatë vitit kalendarik, në të gjitha publikimet periodike të saj, të shkruara dhe elektronike;

b) Nëpërmjet strukturës përgjegjëse, informon publikun, për çdo projektakt, që do të futet në procedurat e shqyrtimit e të miratimit, si dhe njofton publikun e ndikuar, OJF-të mjedisore dhe grupet e tjera të interesit, në formë elektronike dhe shkresore.

2. Njoftimi hartohet me shkrim dhe publikohet vazhdimisht gjatë një muaji.

Njoftimi, i cili shoqërohet me projektaktin normativ dhe relacionin përkatës, përcakton;

a) afatin kohor për studimin nga publiku, i cili nuk mund të jetë më pak se 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit të projektaktit për njohje;

b) vendin, datën dhe orën e organizimit të diskutimit të projektaktit;

c) identitetin e autoritetit publik, përgjegjës për vendimmarrjen.

3. Përfaqësuesit e ministrisë drejtojnë takimin dhe grupi hartues i projektit mban procesverbalin.

4. Grupi hartues i aktit ripunon projektin përfundimtar, duke vlerësuar sugjerimet e publikut dhe të grupeve të interesit.

5. Në relacionin, që shoqëron projektin përfundimtar, pasqyrohen vërejtjet e publikut, të cilat nuk janë reflektuar në material, duke dhënë edhe arsyet.

6. Në përfundim, organit vendimmarrës i përcillet varianti përfundimtar i projektaktit, relacioni shoqërues, bashkë me procesverbalin e debatit me publikun.

7. Projektaktet normative, që i kushtohen mbrojtjes së mjedisit, nuk mund të miratohen nëse nuk plotësojnë kërkesat e këtij kreu, për tërheqjen e mendimit të publikut.

8. Tërheqjes së mendimit të publikut dhe të grupeve të ndikuara, sipas dispozitave të këtij kreu, u nënshtrohen edhe projektaktet, që hartohen në kuadër të projekteve, si dhe ato, që ndërmerren jashtë parashikimeve të matricës. Në këto raste, debatin me publikun dhe pasqyrimin e kërkesave në projektin përfundimtar e realizojnë projektet dhe produkti i tyre nuk merret në dorëzim, nëse nuk janë plotësuar këto kërkesa.

KREU IV
PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMET PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARIVE ME
NDIKIM NË MJEDIS

1. Autoritetet publike, që licencojnë veprimtari me ndikim në mjedis, sigurohen me dokumente se propozuesi i veprimtarisë:

a) ka marrë miratimin e organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit do të ushtrohet veprimtaria, për instalimin dhe funksionimin e veprimtarisë;

b) ka vënë në dijeni publikun e ndikuar dhe ka komunikuar, paraprakisht, me të, për veprimtarinë, që do të ushtrojë;

c) ka marrë, sipas rastit, deklaratë mjedisore, leje mjedisore, leje të integruar, autorizimin ose pëlqimin mjedisor, në kuadër të të cilave është kryer edhe këshillimi me publikun e interesuar.

2. Kërkesat e shkronjave “a” e “b” nuk zbatohen kur projekti a veprimtaria, që do të ushtrohet, ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, kur në dokumentet e tyre ka informacion, që klasifikohet “Sekret shtetëror” apo, për arsye konfidencialiteti, teknologjik e tregtar.

3. Për veprimtaritë, që kanë ndikim në mjedis, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave siguron pjesëmarrjen e publikut, duke zbatuar këto procedura:

a) Brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për t’u pajisur me leje mjedisi, i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, ku do të zbatohet projekti, të organizojë diskutimin me publikun e ndikuar;

b) Dërgon në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dokumentet e projektit a të veprimtarisë, për t'ia vënë në dispozicion publikut.

Me këto dokumente kuptojmë:

i) Një përmbledhje të projektit teknik dhe të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të veprimtarisë, e cila hartohet nga kërkuesi në 10 kopje;

ii) Projektletjen mjedisore për veprimtarinë, në 5 kopje;

iii) Tri kopje të dosjes së plotësuar nga kërkuesi, kur pjesëtarë të publikut duan të njihen në mënyrë të plotë me të.

c) Materialet e kërkuara në shkronjën “b” të kësaj pike, hartohen në gjuhën shqipe dhe me terminologji të thjeshtë.

4. Njësia e qeverisjes vendore dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me mjetet e mundësitë, që kanë, njoftojnë publikun e ndikuar, brenda 5 ditëve, nga data e marrjes së dokumenteve të përmendura në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij vendimi.

5. Njoftimi hartohet me shkrim dhe publikohet gjatë 20 ditëve pa ndërprerje:

a) në radio e tv-të vendore;

b) në faqen e internetit të organit;

c) në botime të përditshme apo periodike, kur është e mundur;

ç) në tabelën e njoftimeve të njësisë së qeverisjes vendore.

6. Njoftimi i qeverisjes vendore përcakton:

a) vendin, ku qëndron i depozituar dokumentacioni;

b) afatin kohor për dhënien e mendimit, i cili është jo më pak se 1 muaj nga data e fundit e shpalljes së njoftimit;

c) vendin, datën dhe orën e organizimit të diskutimit me publikun e ndikuar.

7. Në diskutimin me publikun marrin pjesë specialistë të ministrisë, kërkuesi, me ekspertët e certifikuar, që kanë përgatitur raportin e VNM-së, specialistë të ministrive, që kanë lidhje me këtë veprimtari.

8. Specialistët e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave mbajnë procesverbalin e takimit, ku shënohen të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e publikut.

9. Vërejtjet pasqyrohen në projektletjen. Për propozimet, që nuk reflektohen, jepen argumentet përkatëse.

10. Për veprimtaritë, që miratohen me pëlqim dhe autorizim mjedisor, procedurat e përcaktuara në pikat 3-6 të këtij kreu, zbatohen nga agjencitë rajonale të mjedisit.

11. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe agjencitë rajonale të mjedisit i zbatojnë procedurat e pjesëmarrjes së publikut, të përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi, edhe në rastet e rishikimit apo të ndryshimit të një lejeje mjedisore.

KREU V

PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË KONTROLLIT MJEDISOR

1. Për të mundësuar tërheqjen e mendimit të publikut në kontrollet mjedisore të Inspektoratit të Mjedisit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave informon publikun edhe përmes publikimit në faqen e internetit të:

a) programeve vjetore të kontrollit të Inspektoratit të Mjedisit;

b) programeve vjetore të monitorimit të mjedisit e të përbërësve të tij;

c) planeve mujore të agjencive rajonale të mjedisit.

2. Në grupet e kontrolleve, që organizohen nga Inspektorati i Mjedisit, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të qeverisjes vendore, në territorin e së cilës do të ushtrohet kontrolli, si dhe përfaqësues të publikut e të OJF-ve mjedisore, nëse ka prej tyre një kërkesë me shkrim.

3. Raportet e grupit të inspektimeve, në përfundim të kontrollit, përfshijnë edhe komentet, vërejtjet apo sugjerimet e publikut, që ka ndjekur inspektimin.

4. Një kopje e raportit të kontrollit depozitohet në njësinë e qeverisjes vendore dhe ajo është e hapur gjatë një muaji, për t'u lexuar nga publiku.

5. Ngarkohen autoritetet publike, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të kreut I të këtij

vendimi, për zbatimin e vendimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.995, datë 2.7.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 17 000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lekë.
 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
 3. Paga bazë minimale orare të jetë 98 (nëntëdhjetë e tetë) lekë.
 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
 5. Vendimi nr.235, datë 27.2.2008 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.996, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- a) Prefekti i qarkut të Tiranës
- b) Prefektët e qarqeve të tjera

114 000 lekë;
106 000 lekë;

- c) Nënprefekt i nënprefekturave, Kavajë,
Lushnjë dhe Sarandë 90 500 lekë;
- ç) Nënprefektët e nënprefekturave Krujë,
Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet,
Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 84 000 lekë;
- d) Nënprefektët e nënprefekturave
Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh,
Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë,
Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 78 500 lekë;
- dh) Këshilltar i Prefektit të Tiranës 61 000 lekë;
- e) Zëdhënës i Prefektit të Tiranës 51 000 lekë.”.
2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Në pikën 3 vlera “10 050 lekë” zëvendësohet me “11 000 lekë”.
4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
- “5. Shtesa për kualifikim, (kolona 3), e lidhjes nr.1, përcaktohet, si më poshtë vijon:
- Nëpunësit në prefektura dhe nënprefektura përfitojnë shtesën, për kualifikim, gradë apo titull shkencor, të përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:
- a) Shtesa jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor është në përputhje me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.
- b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij të punës, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për këtë pozicion.
- c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij të punës, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet vendimit, e përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin shkencor.
- Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli shkencor, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesë vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë.
- Për aplikimin e shtesës për kualifikim, zbatohen rregullat e udhëzimit nr.1, datë 18.4.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.”.
5. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:
- “5/1. Shtesën për kualifikim, gradë apo titull shkencor, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e përfitojnë edhe “Prefekti”, “Nënprefekti”, “Këshilltari i Prefektit të Tiranës” dhe “Zëdhënësi e Prefektit të Tiranës”. Kriteret e përfitimit të shtesës, të përcaktuara sipas pikës 5 të këtij vendimi, zbatohen edhe për këta funksionarë.”.
6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:
- “6/1. “Specialisët”, “Përgjegjësit e zyrës” apo “Përgjegjësit e sektorit”, në prefektura dhe nënprefektura që janë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe që kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, punonjës me arsim të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për kushte pune, prej 10 000 lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e pagave, për vitin 2008.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

EMËRTIMI	KATEGORITË	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA PËR POZICION
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG), lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK), lekë	Shtesa për pozicion (SHP), lekë
Sekretar i përgjithshëm në prefekturë	III-a	11 000	2%		68 500
Sekretar i përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë	III-a/1	11 000	2%		58 300
Përgjegjës sektori në prefekturë	III-b	11 000	2%		51 500
	IV-a	11 000	2%		39 000
Përgjegjës zyre në prefekturë, Përgjegjës zyre në nënprefekturë	IV-a	11 000	2%		39 000
Përgjegjës sektori në nënprefekturë, Inspektor auditit në prefekturë	IV-a	11 000	2%		39 000
Specialist në prefekturë	IV-b	11 000	2%		29 000
	IV-c	11 000	2%		21 500
Specialist në nënprefekturë	IV-c	11 000	2%		21 500
Sekretar	IV-c	11 000	2%		21 500

LIDHJA NR.2

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHITESA (LEKË/MUAJ)
Prefekt	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Nënprefekt, Sekretar i përgjithshëm	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës sektori në prefekturë dhe nënprefekturë, Përgjegjës zyre në prefekturë dhe nënprefekturë, Inspektor, Specialist në prefekturë dhe nënprefekturë	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i nivelit të dytë, Studime specializuese afatgjata	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000

Shënim. Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare”, dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, zbatohen për nëpunësit dhe funksionarët, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet apo shkollat e arsimit të lartë në vendet e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.997, datë 2.7.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohet emërtesa “Administrata e Akademisë së Shkencave”.
 2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 5. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
 “4. Paga e grupit, (kolona 1), e lidhjeve nr.1, nr.1/1 e nr.2, “Diplomë e shkollës së lartë”, është 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekë.”.
 6. Në pikën 5, pas fjalëve “...nr.2...” shtohen f“...e nr.1/1...”.
 7. Paragrafi i parë i pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:
 “6. Shtesa për kualifikim, (kolona 3), e lidhjeve nr.1, nr.1/1 e nr.2, përcaktohet si më poshtë vijon:”.
 8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e pagave, për vitin 2008.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA PËR POZICION
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
Titullari i institucionit	II-a	11 000	2%		103 500
Zv/titullar i institucionit, Drejtor drejtorie	II-b	11 000	2%		86 500
Anëtar i organit drejtues	III-a	11 000	2%		68 500
Përgjegjës sektori,	III-a/1	11 000	2%		58 300

Përgjegjës i bibliotekës shkencore në Akademinë e Shkencave					
Përgjegjës sektori, Kryetar dege në Akademinë e Shkencave, Inspektor, Redaktor në Akademinë e Shkencave	III-b	11 000	2%		51 500
Asistent seksioni në Akademinë e Shkencave, Bibliografë në Akademinë e Shkencave	IV-a	11 000	2%		39 000
Specialist	IV-a	11 000	2%		39 000
	IV-b	11 000	2%		29 000

LIDHJA NR.1/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

PAGA MUJORE						
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	
Titullari i institucionit	II-a	11 000	2%		103 500	20 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	11 000	2%		86 500	15 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	11 000	2%		86 500	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	11 000	2%		58 300	20 000
Përgjegjës sektori në	III-a/1	11 000	2%		58 300	0
	III-b	11 000	2%		51 500	0

sektorët mbështetës						
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes	III-b	11 000	2%		51 500	25 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-a	11 000	2%		39 000	0
	IV-b	11 000	2%		29 000	0

LIDHJA NR.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSTITUCIONEVE
RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE QENDRORE NË VARËSI TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
Titullari i institucionit rajonal	III-b	11 000	2%		51 500
Titullari i institucionit vendor Përgjegjës sektori në institucionet rajonale	IV-a	11 000	2%		39 000
Përgjegjës sektori i institucionit vendor, Specialist në institucionet rajonale	IV-b	11 000	2%		29 000
Specialist në institucionet vendore	IV-c	11 000	2%		21 500

VENDIM
Nr.998, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.317, DATË 30.5.2007 TË

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE
TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT TË MINISTRISË SË
BRENDSHME, DURRËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në pikën 2, vlera “10 050 lekë” bëhet “11 000 lekë”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Shtesa për kualifikim, (kolona 3), e lidhjes nr.1, përcaktohet, si më poshtë vijon:

Nëpunësit në pozicionet “Specialist”, “Përgjegjës sektori” dhe “Drejtor”, që paguhen sipas lidhjes nr.1, përfitojnë shtesën për kualifikim, gradë apo titull shkencor, të përcaktuar në lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit të shtesë janë:

a) Për nëpunësit, kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhen me përshkrimin e pozicionit të punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij të punës, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për këtë pozicion.

c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij të punës, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, e përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin.

Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli që kanë, nëpunësit përfitojnë vetëm shtesën për gradën apo titullin shkencor më të lartë, që kanë.

Për aplikimin e shtesës për kualifikim zbatohen rregullat e udhëzimit nr.1, datë 18.4.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.”.

4. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara nga politikat e rritjes së pagave, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

LIDHJA NR.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR POZICIONET “SPECIALIST”, “PËRGJEGJËS
SEKTORI” DHE “DREJTOR”, NË SHTËPINË E PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME,
DURRËS**

EMËRTIMI	PAGA MUJORE		
	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)	SHTESA PËR

					POZICION
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG), lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK), lekë	Shtesa për pozicion (SHP), lekë
Drejtor	III-a	11 000	2%		68 500
Përgjegjës sektori	IV-a	11 000	2%		39 000
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, që gëzojnë të drejtën e gradës diplomatike dhe që paguhen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfitojnë shtesën për kualifikim, gradë apo titull shkencor, të përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Kjo shtesë jepet në kushtet e përputhjes së fushës së kualifikimit, gradës, apo titullit shkencor, me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për

pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton shtesë, në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin që ka.

Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën, apo titullin shkencor më të lartë, që ka.

Për aplikimin e shtesës për kualifikim zbatohen rregullat e udhëzimit nr.1, datë 18.4.2008, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë të Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.”.

3. Efektet financiare për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, të planifikuara për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LIDHJA NR.1

	PAGA MUJORE				
POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR GRADË
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP), lekë
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	11 000	2%		114 000
Drejtor i Përgjithshëm	Ministër Fuqplotë, Ministër Këshilltar, Konsull i Përgjithshëm	11 000	2%		103 500
Drejtor	Këshilltar	11 000	2%		86 500
Përgjegjës sektori	Sekretar i parë, Konsull	11 000	2%		68 500
	Sekretar i dytë, Zëvendëskonsull	11 000	2%		51 500
	Sekretar i tretë, Agjent konsullor	11 000	2%		39 000
	Atashe	11 000	2%		29 000

LIDHJA NR.2

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/ TITULLI SHKENCOR	SHITESA (LEKË/MUAJ)
Sekretar i Përgjithshëm	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor.	Doktor i shkencave	20 000
	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës sektori, Specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/masteri nivelit të dytë, Studime specializuese afatgjata	10 000

	Studime të thelluara pasuniversitare/master i niveleit të dytë	20 000
--	--	--------

Shënim. Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare”, dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i shkencave”, zbatohen për nëpunësit, që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet apo shkollat e arsimit të lartë në vendet e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.1003, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2, vlera “10 050 lekë” zëvendësohet “11 000 lekë”.

c) Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin dhe nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përcaktohen si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri 134 000 lekë;

- Drejtori i kabinetit të Kryeministrit, barazohet në pagë me nëpunësin civil, të kategorisë I-a;

- Këshilltar i Kryeministrit, shefi i Protokollit të Kryeministrit, dhe drejtori i kabinetit të zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Ndihmësi i Kryeministrit dhe këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil, të kategorisë I-b;

- Ndihmësi i zëvendëskryeministrit dhe drejtori i kabinetit të ministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil, të kategorisë II-a;

- Këshilltari i ministrit dhe zëdhënësi barazohen në pagë me nëpunësin civil, të kategorisë II-b;

- Sekretar i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, zëvendësministrit dhe nënkryetarit të Kuvendit

62 500 lekë;

- Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit

50 000 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionet “Sekretar i Kryeministrit”, “Sekretar i Presidentit”,

“Sekretar i Kryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i zëvendëskryeministrit”, “Sekretar i nënkryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i ministrit”, “Sekretar” dhe “Sekretar i këshilltarit të Presidentit” jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 11 000 lekë.

Këshilltarët e jashtëm të Kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit përfitojnë pagesë mujore, deri në 40 për qind të pagës mujore, të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga titullari i institucionit përkatës.

Këto nivele pagash zbatohen edhe për funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e politikës së pagave, të miratuara për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

	PAGA MUJORE				
KLASA	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP), lekë
I	I-a	11 000	2%		126 000
	I-b	11 000	2%		114 000
II	II-a	11 000	2%		103 500
	II-b	11 000	2%		86 500
III	III-a	11 000	2%		68 500
	III-a/1	11 000	2%		58 300
	III-b	11 000	2%		51 500
IV	IV-a	11 000	2%		39 000
	IV-b	11 000	2%		29 000

LIDHJA NR.3

KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË
KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Jurist në Departamentin e Legjislacionit, Koordinimit& Dokumentacionit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ&Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive&Koordinimit të Ndihmës së Huaj	II-b
	Koordinator në Departamentin e Legalizimit&Formalizimit të Ekonomisë Ekstraligjore	II-b
	Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave	II-b

	Koordinator në Departamentin e Informacionit	II-b
	Drejtor i Njesisë së Teknologjisë së Informacionit dhe e-Government	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i zyrës së përfaqësuesit ligjor	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtor i Njesisë Antitrafik	II-a
	Drejtor i Njesisë së Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara	II-a
	Koordinator në Departamentin e Administratës Publike	III-a
	Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit	III-a
	Koordinator në Njësine Antitrafik	III-a
	Koordinator në Njësine të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm apo në sektorët e auditimit të brendshëm	III-a III-b

UDHËZIM
Nr.6364, datë 3.7.2008

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.794, DATË 21.11.2007
“PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET APO
TRANSFORMOHET DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave nxjerrin këtë

UDHËZIM:

1. Të gjitha miratimet e privatizimit, para hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, do të konsiderohen të vlefshme. Afati i plotësimit të dokumentacionit në këtë rast do të fillojë me ngritjen e komisionit të vlerësimit në zbatim të kreut 1, pika 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007.

2. Institucionet qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore dërgojnë prononcimin e tyre për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo institucioneve, në administrim apo pronësi të tyre, në ministrinë përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore.

Për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat të cilat i kanë kaluar në pronësi pushtetit vendor, nevojitet miratimi perkates i këshillit bashkiak/të komunës apo qarkut, ndërsa për pronat të cilat janë në administrim të këtyre institucioneve, nevojitet vetëm miratimi i kryetarit të bashkisë/ komunës apo qarkut përkatës.

3. Vlerësimi i pasurisë shtetërore në zbatim të këtij vendimi bëhet për çdo element të pasurisë nga komisioni i vlerësimit, duke përcaktuar vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

4. Komisioni i vlerësimit për pasuritë e paluajtshme ngrihet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe do të përbëhet nga jo më pak se 4 anëtarë. Komisioni i vlerësimit do të kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën përkatëse ku ndodhet objekti dhe në përbërje të tij do të jenë përfaqësuesi i institucionit në administrim të të cilit ndodhet objekti, si dhe grupi i ekspertëve vlerësues. Ky grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë vlerësues të pasurisë së paluajtshme, si dhe ekspertë kontabël të autorizuar të fushës përkatëse, sipas rastit.

5. Miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si elemente të veçantë, behet nga institucioni përkatës i varësise administrative. Pas nxjerrjes së miratimit të privatizimit, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit, i cili kryen vlerësimin e pasurisë. Ky komision duhet të ketë jo

më pak se 3 anëtarë, kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës administrative dhe në përbërje të tij duhet të ketë një ekspert vlerësues të fushës përkatëse.

Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e eksperteve etj.) në rastin e mësipërm mbulohen nga institucioni ose ndërmarrja në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

6. Ekspertët në përbërje të komisionit, të cilët hartojnë aktet vlerësuese, situacionet, genplanet etj., si dhe komisioni i vlerësimit mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit të kryer prej tyre, si dhe për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre.

7. Ekspertët në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës se paluajtshme shtetërore përzgjidhen nga ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore.

8. Komisioni i vlerësimit me marrjen e urdhërit përkatës, inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit. Pas këtij verifikimi ekspertët hartojnë programin e punës ku duhet të argumentojnë kohën e nevojshme për vlerësim (orët e punës) i cili do t'i dorëzohet Kryetarit të Degës së Shoqërive Publike.

Pas verifikimit dhe saktësimit të programit të punës nga Dega e Shoqërive Publike, hartohet proces verbal i lidhur me orët e domosdoshme për vlerësimin e objektit, i cili firmoset dhe vulloset nga kryetari i Degës së Shoqërive Publike dhe ekspertët.

Ky proces verbal në origjinal përcillet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe më pas hartohet kontrata e pagesës së ekspertëve me palën shtetërore, Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare pranë kësaj ministrie.

Në këtë rast pagesa e ekspertëve lidhur me misionin e vlerësimit do të bëhet për çdo miratim privatizimi. Paga orare do të jetë 1500 lekë (njëmijë e pesëqind) për orë pune.

Në rastin e vlerësimit të objekteve që do të përfshihen në fondin e kompesimit Fizik për ish-pronarët, pagesa e ekspertëve do të bëhet sipas procedurës së mësipërme (dokumentacioni i duhur për të vërtetuar punën) për çdo objekt të vlerësuar dhe paga orare do të jetë 1500 lekë (njëmijë e pesëqind) për orë pune.

Pagesa në të dy rastet e mësipërme do të kryhet nga të ardhurat e marra nga privatizimi dhe dhënia me qira e pronës shtetërore nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për rastin kur objektet pasi janë zbritur nga kapitali themeltar i shoqërive tregtare shtetërore, janë miratuar për privatizim, ekspertët vlerësues dhe kontabël që do të kryejnë vlerësimin e objektit, sipas miratimit të privatizimit do të paguhet nga shoqëria. Kontrata e pagesës së ekspertëve do të lidhet ndërmjet ekspertëve dhe titullarit të shoqërisë, sipas orëve të punës të negociuara ndërmjet tyre.

Pagesa e ekspertëve për vlerësimin e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore, të formës anonime ose me përgjegjësi të kufizuar, mbulohet nga shoqëritë përkatëse. Në rast mospagese nga ana e shoqërisë, atëherë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës merr përsipër pagesën e ekspertëve.

9. Truall që privatizohet konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale rreth tij, e përcaktuar sipas genplanit të objektit që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit që përgatit komisioni i vlerësimit të ndërmarrjes sipas pikës 3, 4 të kreut III-të të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007.

10. Kur ish-pronari i truallit është pronar i objektit duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 2, kapitulli IV i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 trualli kalon në favor të tij pa shpërbllim. Ndërsa kur ish-pronarët e truallit nuk kanë përfutur objekt në trojet ish-pronë e tyre, iu lind e drejta e kompensimit fizik për të shlyer trojet e shitura, siç përcaktohet në nenin 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve".

11. Në zbatim të pikës 9 në kreun e III-të, komisioni i vlerësimit pas marrjes së dokumentacionit nga organi i qeverisjes vendore, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin nëse trualli përkatës ka pronarë të njohur, si dhe çmimin e shitjes së truallit në zonën përkatëse, përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.183, datë 28.4.2005 "Për miratimin e metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme që kompensohet dhe asaj që do të shërbejë për kompensim." Në rastet kur ky çmim nuk ekziston, atëherë ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin aktual të tregut të shitjes së truallit që do të privatizohet.

12. Kur objekti është me dy a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit në bazë të kërkesës së tyre për çdo pronar bëhet në bashkëpronësi të pandashme mes pronarëve të objektit. Bashkëpronarët u nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil p.sh.:

- Objekti me 3 kate është ndërtuar mbi një sipërfaqe 500 m² (sipërfaqe ndërtimi + mjedisin e përbashkët + sipërfaqen e bordurës + sipërfaqen e truallit në oborr, nëse ka).

- Sipërfaqja e ndërtimit pa ambientet e përbashkëta është 1250 m² dhe për çdo kat është: kati i I-rë 450 m² dhe kati II-të 450 m² dhe kati III-të 350 m².

Llogarisim koeficientin (k)

$$K = \frac{\text{Sipërfaqe trualli}}{\text{Sipërfaqe ndërtimi}}$$

$$K = \frac{500 \text{ m}^2}{1250 \text{ m}^2}$$

$$K = 0.4$$

Koeficienti është konstant, duke u shumëzuar me sipërfaqet përkatëse të ndërtimit që zë secili pronar, jep sipërfaqen përkatëse që i takon të privatizojë secili pronar. Në një kat mund të jetë një ose më shumë pronarë. Në rastin tonë në shembull kemi vetëm nga një pronar në çdo kat. Konkretisht:

Për katin I-rë	$450 \text{ m}^2 * 0,4 = 180 \text{ m}^2$
Për katin II-të	$450 \text{ m}^2 * 0,4 = 180 \text{ m}^2$
Për katin III-të	$350 \text{ m}^2 * 0,4 = 140 \text{ m}^2$

Këto sipërfaqe, të cilat përcaktohen nga ekspertët vlerësues, duke u shumëzuar me çmimin për m^2 të llogaritur nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Truallit ish-pronarëve, japin vlef të duhet të paguajë në lekë secili pronar.

13. Në zbatim të pikës 11, kreu III-të, për rastet e privatizimit tërësor të ndërmarrjeve, të linjave të shërbimit dhe të prodhimit, të objekteve së bashku me makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros etj., që janë pjesë përbërëse të objektit: objektet ndërtimore të veçanta, pasi të kenë kaluar të gjitha procedurat, do të kontrollohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe do të dërgohen në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Ndërsa dokumentacioni i vlerësimit të pasurive të luajtshme, si makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, mjetet e xhiros etj., që privatizohen të veçuara, pasi përgatitet nga komisioni i vlerësimit, përcillet prej tij në degën e shoqërive publike përkatëse, e cila pas kontrollit e dërgon në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

14. Vlerësimi i aseteve, kontrata e shitjes së të cilave është shpallur e pavlefshme nga gjykata, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme dhe dosjet e tyre janë kthyer në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Financave, bëhet nga komisioni i vlerësimit, i ngritur për këtë qëllim nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sipas gjendjes faktike të tyre, duke përcaktuar vlerën e tregut.

15. Në zbatim të pikës 2 të kreut IV-t të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007, privatizimi (shitja) i objekteve dhe i truallit të tyre, makinerive, pajisjeve etj. bëhet me lekë.

16. Në zbatim të pikës 4, kreu i IV-t, për rastet e shitjes së objekteve për të cilat është konfirmuar se ka pronar trualli, Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) afishon njoftimin në ambientet e saj, ndërsa dega e shoqërive publike përkatëse (sipas të dhënave të dërguara nga DASHPP) në objekt dhe ambientet e ndërmarrjes që e administron atë. Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, brenda një afati 20-ditor nga dita e publikimit (afishimit), duke depozituar kërkesën me shkrim, në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin në fjalë, dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20% të vlerës së objektit (mjete kryesore+mjete xhiro), pa vlerën e truallit që kërkon të blejë, dhe vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të noterizuar apo çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili përcakton se ai është pronar i tokës.

17. Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike për çdo rast për verifikimin e dokumentacionit të pronësisë, sipas dosjes së vlerësimit të dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ish-pronarit të truallit, krijon komisionin e përbërë nga shefi i sektorit të shitjes së pronave, një specialist dhe një jurist.

18. Në rast se brenda këtij afati kohor ish-pronari nuk paraqitet, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike bën një njoftim të dytë në një afat prej 30 ditësh në dy gazeta me qarkullim kombëtar dhe njoftohet pronari. Nëse edhe pas këtij njoftimi nuk paraqitet pronari i truallit për blerjen e objektit, atëherë realizohet shitja me ankand e objektit dhe e truallit, sipas procedurave të këtij vendimi. Vlera e truallit, e përcaktuar në dosjen e vlerësimit, do të derdhet në llogari të AKKP-së për të kompensuar pronarin.

19. Në rastet kur konfirmohet se objekti nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuar, ai i nënshtrohet ankandit sipas procedurave të këtij vendimi dhe në qoftë se ditën e zhvillimit të ankandit paraqitet subjekti i shpronësuar me dokumentet përkatëse të pronësisë, atëherë ai gëzon të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare të tij. Për rastet kur komisioni i ankandit ka vështirësi në

vlerësimin e dokumentacionit të pronësisë të paraqitur nga pronari i truallit, atëherë komisioni i ankandit cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e mëparshme, me qëllim që të vlerësojë dokumentacionin e pronësisë. Ky afat miratohet edhe nga drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

20. Për rastet kur në ankandin për shitjen e objekteve apo aseteve me vlerë fillestare, me vlerë të ulur dhe me rezervë paraqitet vetëm një kërkesë përpara komisionit të ankandit, komisioni duhet ta evidentojë këtë kërkesë në procesverbalin e ankandit dhe objekti t'i nënshtrohet procedurës së ripublikimit sipas pikës 21, kapitulli IV i këtij vendimi.

21. Në zbatim të pikës 5, kapitulli i IV-t, me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit për shitjen e makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike afishon njoftimin në ambientet e saj dhe një kopje të afishimit e dërgon në degën e shoqërive publike të prefekturës ku ndodhet ndërmarrja që i ka në administrim ato për t'i afishuar në ambientet e saj. Punonjësit që i kanë ose i kanë pasur në përdorim makineritë, automjetet, pajisjet apo mjetet e punës dhe dëshirojnë t'i blejnë, duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike brenda afatit 20-ditor të afishimit, kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20% të vlefës së pronës që kërkon të blejë, si dhe vërtetimin që i ka apo i ka pasur në përdorim këto asete, lëshuar nga drejtori i ndërmarrjes.

22. Në rast se punonjësit, që i kanë pasur ose i kanë në përdorim mjetet, nuk paraqesin kërkesë për blerjen e tyre brenda afatit të përcaktuar më lart, ato kalojnë në publikim sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007. Në këtë rast Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike njofton dhe organet e rendit në prefekturë për automjetet apo mjetet e transportit që janë në procedurë privatizimi për t'i bllokuar ato deri në përfundimin e privatizimit të tyre. Me lidhjen e kontratës së shitblerjes, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike njofton organet përkatëse të rendit për transferimin e lejes së qarkullimit të automjetit te pronari i ri, konform akteve normative në fuqi.

23. Në zbatim të pikës 7, kapitulli i IV-t, punonjësit specialistë, farmacistë ose stomatologë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes (me kushtin që këto specialistë të kenë zbatuar me korrektësi kontratën e qirasë, të jenë regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti, të ushtrojnë profesionin në objektin përkatës etj.) sipas çmimit të përcaktuar në ankand (çmimi më i lartë i dhënë nga pjesëmarrësit në ankand u ofrohet punonjësve të këtij shërbimi, në rast se çmimi i arritur në ankand nuk pranohet nga punonjësit e këtij shërbimi, atëherë komisioni shpall fitues pjesëmarrësin që ka dhënë çmimin më të lartë në ankand), vetëm në ato raste kur për këto objekte nuk ka pronarë truall të njohur me vendime të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, të cilët kanë të drejtën e parablerjes.

24. Në rastin kur është konfirmuar në dosjen e vlerësimit apo kur subjektet e shpronësuara të truallit të objektit kanë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë dhe kërkesën për blerjen e objektit sipas pikës 16 të kapitullit IV, por nuk paraqiten në ankandin e objektit që ndodhet në pronën e tyre, komisioni i ankandit evidenton kërkesat për blerje në procesverbalin përkatës dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda shtatë ditëve nga data e mëparshme e zhvillimit të ankandit, duke njoftuar edhe njëherë pronarët e truallit. Nëse edhe në këtë datë pronarët e truallit nuk paraqiten për blerjen e objektit me të drejtën e parablerjes, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike do të veprojë sipas pikës 4, germa "b", kapitulli IV i këtij vendimi.

25. Në zbatim të pikës 41, kapitulli IV, i këtij vendimi, vlerësimi i investimeve të pasurisë së paluajtshme në rastet e pasurive shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë, do të bëhet nga ekspertë vlerësues të licencuar të pasurisë dhe eksperti kontabël, i autorizuar, të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili urdhëron fillimin e procedurës së mësipërme.

26. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, sektori i monitorimit të qirasë, i paraqet për miratim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vlerën e investimeve të kryera nga qiramarrësi dhe të vlerësuar nga ekspertët përkatës. Me miratimin e vlerës së investimeve, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin e kësaj vlere dhe vlerës së truallit, të përcaktuar sipas çmimit të truallit të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipërfaqes së truallit në kontratën e qiramarrjes. Nëse vlera e investimeve të kryera është mbi 150% e vlerës së truallit, Ministri nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit.

27. Në zbatim të pikës 10 kreu IV, ankandi do të zhvillohet mbi vlerën e mjeteve kryesore+vlera e truallit, ndërsa vlera e mjeteve të xhiros do të shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit.

28. Gjithashtu Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike me urdhër të drejtorit, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mund të përdorë edhe forma të tjera

publikimi në media televizive, postera etj. Shpenzimet e publikimit do të përballohen nga të ardhurat e privatizimit.

29. Në zbatim të pikës 15, kapitulli i IV-t, pjesëmarrësit në ankand në vendin, datën dhe orën e njoftuar duhet të paraqesin pranë komisionit të ankandit edhe dokumentin e identifikimit të tyre (letërnjoftim, certifikatë me fotografi). Disa persona kanë të drejtën e paraqitjes për blerje të objektit së bashku me një kërkesë të vetme. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me dokumentin bankar që përmban emrat e personave që bashkohen në këtë blerje. Në rast të paraqitjes së një blerësi, personat e tjerë kërkuar duhet të përfaqësohen me prokurë.

30. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për raste kur në dokumentacionin e vlerësimit të objektit të dërguar për privatizim, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës konstaton mospërputhje të hartës treguese me genplanin e dosjes apo ka mungesa të të dhënave hartografike në HTR etj., kërkon informacion plotësues nga ZVRPP.

31. Në zbatim të pikës 22, kreu IV, pas shpalljes së fituesit të ankandit për shitjen me rezervë (për afatin më të shkurtër kohor të likuidimit të vlerës së objektit+vlerën e truallit+vlerën e mjeteve të xhiros), Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave nënshkruan me fituesin e ankandit aktmarrëveshjen në të cilën pasqyrohen afatet e likuidimit, vlera e kësteve që do të shlyhen, dorëzimi i objektit etj. Kjo aktmarrëveshje do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes që do të lidhet për objektin.

32. Në zbatim të pikës 35, kreu i IV-t, personi që ka fituar të drejtën e blerjes për objektin dhe nuk paguan vlerën e plotë të tij brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij si fitues ankandi apo pronar truall, humbet vlerën prej 20% të paguar për pjesëmarrje në ankand, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përsëri në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e objektit në fjalë.

33. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, dhe për procedurën e shitjes” dhe këtij udhëzimi për zbatimin e këtij vendimi ka të drejtë të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatëse në përputhje të akteve ligjore në fuqi, për të rritur efikasitetin e privatizimit.

34. Publikimi për shitje për objektin që do të privatizohet, përveç informacionit plotësues të përcaktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, përmban edhe tabelën me të dhënat sipas formatit si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit (në lekë) (Mjete kryesore+vlera e truallit)	Mjete xhiroje (në lekë)	Sipërfaqja gjithsej e objektit (në m ²)	Sipërfaqja nën objektit (në m ²)	Vlera e truallit (në lekë)
1.							
2.							
...							

35. Për rastet e publikimit (afishimit) për ish-pronarët e truallit (tabela do të jetë e njëjtë vetëm se në kolonën “Vlera fillestare e ankandit do të jetë (Vlera e mjeteve kryesore + vlera e mjeteve të xhiros) pra, pa vlerën e truallit”.

36. Në zbatim të pikës 9, kreu i IV-t i këtij vendimi, dokumentacionet e vlerësimit të objekteve ndërtimore të pashitura edhe pas zbatimit të të gjitha fazave të shitjes së këtij vendimi, do të përcillen në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për t’u përdorur si fond kompensimi fizik. Ndërsa dosjet e vlerësimit të makinerive, pajisjeve etj., të cilat kanë mbaruar procedurën e privatizimit dhe rezultojnë të pashitura kthehen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kjo e fundit i kthen në ndërmarrje apo institucionin e varësisë administrative, i cili zbaton procedurat përkatëse ligjore të nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre.

37. Udhëzimi nr. 1, datë 27.12.2007 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS

Genc Ruli

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 22.7.2008
Doli nga shtypi më 24.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë